

MEMORANDUM

Në lidhje me reformën e dispozitave të fyerjes dhe shpifjes në Kodin Penal dhe Kodin Civil

- Drejtuar:** z. Aldo Bumçi, Ministër i Drejtësisë
z. Vladimir Kristo, Zëvendësministër i Drejtësisë
z. Viktor Gumi, Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit
- Për Dijeni:** z. Ilir Rusmajli, Zëvendëskryeministër
znj. Valentina Leskaj, Kryetare e Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
z. Ylli Pango, Nënkryetar i Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
- Nga:** Remzi Lani, Instituti Shqiptar i Medias
Darian Pavli, Open Society Justice Initiative
-

1. Tendanca drejt depenalizimit të figurave të fyerjes dhe shpifjes

Reformimi i kuadrit ligjor të fyerjes dhe shpifjes (ose difamacionit në përgjithësi) ka qenë një prioritet i shpallur i qeverive të ndryshme shqiptare gjatë gjithë periudhës së tranzicionit dhe sidomos në dhjetë vitet e fundit. Duhet thënë, megjithatë, që për arsye të ndryshme deri në këtë moment këto angazhime kanë mbetur në nivelin deklarativ, ndërkohë që disa procese gjyqësore të filluara vitet e fundit nga ish-funkionarë të lartë të ekzekutivit dhe familjarë të tyre kundër mediave kanë cënuar disi imazhin e demokracisë shqiptare në botë. Së fundmi, pozicionimi publik i Kryeministrit Berisha, me udhëzimin për administratën e lartë që të evitoje proceset gjyqësore ndaj mediave për fyerje e shpifje në favor të mjeteve të tjera të mbrojtjes së të vertetes dhe reputacionit, ka krijuar shpresa për një zgjidhje perfundimtare të problemit.

Këto zhvillime të brendshme janë shoqëruar edhe me kërkesa në rritje të institucioneve të ndryshme europiane që Shqipëria të forcojë mekanizmat për mbrojtjen e lirisë së shprehjes, dhe në veçanti duke reformuar kuadrin ligjor të difamacionit. Vlen të përmendet këtu Rezoluta 1377 e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës (2004), e cila kërkon të "shfuqizohen ose të rishikohen thelbësisht ligjet penale mbi difamacionin dhe të reformohet e drejta civile e difamacionit në mënyrë që të parandalohet zbatimi abuziv i tyre."¹ Po ashtu, raportet e dy viteve të fundit të Bashkimit Europian në lidhje me ecurinë e procesit të integritetit europian i janë referuar shprehimisht domosdoshmërisë së reformës në këtë fushë.

¹ Miratuar në 29 prill 2004, pika 16.iv. Duhet theksuar se kjo rezolutë është miratuar pas një debati në lidhje me "respektimin e detyrimeve dhe angazhimeve të Shqipërisë" ndaj Këshillit të Europës, përfshirë këtu edhe në kuadrin e Koventës Europiane për të Drejtat e Njeriut: [https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=Pr254\(2006\)&Sector=secDC&Language=lanEnglish&Ver=original&BackColorInternet=F5CA75&BackColorIntranet=F5CA75&BackColorLogged=A9BACE](https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=Pr254(2006)&Sector=secDC&Language=lanEnglish&Ver=original&BackColorInternet=F5CA75&BackColorIntranet=F5CA75&BackColorLogged=A9BACE).

Këto kërkesa nuk janë unike apo endemike për Shqipërinë. Në fakt, ato përkohë me një tendencë të përgjithshme në demokracitë e reja europiane e më gjerë, shumë prej të cilave ose i kanë tejkaluar sanksionet penale ndaj fjalës së lirë, ose i kanë reformuar ato thellësisht. Kjo tendencë duket qartë qoftë në deklaratimet e institucioneve të specializuara ndërkombëtare (i ashtuquajturit 'soft law'), qoftë në praktikën e vendeve relevante. Për shembull,

- me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Lirisë së Shtypit 2006, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës Terry Davis u bëri thirrje të gjitha shteteve anëtare të shfuqizojnë dispozitat penale të difamacionit dhe të evitojnë caktimin e dëmeve morale në nivele të tepruara ose joproporcionale.² Davis theksoi se fakti që sanksionet penale vazhdojnë të ekzistojnë teorikisht në rreth dy të tretat e vendeve anëtare të KE-së nuk e zhvlerëson faktin që ato bëhen shpesh objekt abuzimi.
- Tre raportet e lirisë së shprehjes të Kombeve të Bashkuara, OSBE-së dhe Komisionit Inter-Amerikan të të Drejtave të Njeriut (dhe së fundmi edhe Raporteri i Komisionit Afrikan) janë shprehur shpesh kundër penalizimit të difamacionit në deklaratat e tyre të përbashkëta, duke kërkuar zëvendësimin e sanksioneve penale me ato civile.³

Nga këndvështrimi i praktikës europiane, mund të përmendim të dhënat e mëposhtme:

- një studim i ndërmarrë nga Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias ka konkluduar se gjatë dhjetë vjetëve të fundit rreth 70 për qind e vendeve anëtare të OSBE-së kanë ndërmarrë reforma të ndryshme në kuadrin ligjor të difamacionit. Rreth **14 vende** ose kanë bërë depenalizimin e figurës, ose janë në proces shqyrtimi. Sipas këtij studimi, vetëm nëntë nga 55 vendet anëtare kanë pranuar se aplikojnë dënimin me heqje lirie për vepra difamacioni.⁴
- Rreth gjysma e vendeve anëtare të KE-së "kanë ndërmarrë hapa konkrete ose janë duke shqyrtuar masa për depenalizimin e difamacionit ose uljen e sanksioneve që mund të zbatohen në këtë fushë." Në praktikë, shumica dërrmuese e vendeve të KE-së nuk i zbatojnë sanksionet penale për difamacion.⁵

² Deklarata e plotë gjendet ketu:

[https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=Pr254\(2006\)&Sector=secDC&Language=lanEnglish&Ver=original&BackColorInternet=F5CA75&BackColorIntranet=F5CA75&BackColorLogged=A9BACE](https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=Pr254(2006)&Sector=secDC&Language=lanEnglish&Ver=original&BackColorInternet=F5CA75&BackColorIntranet=F5CA75&BackColorLogged=A9BACE).

³ Shih për shembull Deklaratën e vitit 2002, paragrafi i fundit i së cilës shprehet (në origjinalin anglisht): "Criminal defamation is not a justifiable restriction on freedom of expression; all criminal defamation laws should be abolished and replaced, where necessary, with appropriate civil defamation laws":
<http://www.unhchr.ch/hurricane/hurricane.nsf/view01/2D8D8FAD6977D4A5C1256C8C00493AF7?opendocument>.

⁴ Cituar nga Council of Europe Secretariat, "Examination of the Alignment of the Laws on Defamation with the Relevant Case-Law of the European Court of Human Rights, Including the Issue of Decriminalisation of Defamation" (2005), para. 52:
[http://www.coe.int/t/e/human_rights/media/1_Intergovernmental_Co-operation/CDMC/CDMC\(2005\)007_en.pdf](http://www.coe.int/t/e/human_rights/media/1_Intergovernmental_Co-operation/CDMC/CDMC(2005)007_en.pdf). Ky i fundit është një dokument mjaft i plotë, korrent dhe analitik mbi të drejtën e difamacionit në Europë dhe tendencat e zhvillimit të saj. Analiza u përgatit nga Sekretariati me kërkesën e Komitetit të Ministrave të KE-së në kuadrin e axhendës së reformave në këtë fushë.

⁵ Ibid, paras. 7-8.

- Po ashtu, në studimin e KE-së (shih shënimin 4) theksohet se Gjykata e Strasburgut, megjithëse nuk ka adoptuar një qëndrim absolut kundër difamacionit penal, në praktikë nuk ka pasur asnjë rast të vetëm që kjo Gjykatë të ketë lënë në fuqi dënime me burgim për difamacion të thjeshtë (dmth pa elementë nxitjeje dhune apo urrejtjeje etnike etj).
- Studimi i KE-së konkludon me pohimin se, në nivelin ndërkombëtar, zhvendosja e mentalitetit nga lëmi i sanksioneve penale tek ato civile “duket se është bërë unanime.”

Më konkretisht në praktikën europiane:

- Bosnia-Herzegovina (2002), Estonia (2002), Gjeorgjia (2004), Moldova (2004), Qipro (2003) dhe Ukraina (2004) kanë bërë **depenalizim të plotë** të difamacionit (është hequr edhe nga projekt-kodi penal i ri i Rumanisë);
- Bulgaria (1998), Franca (per difamacion të thjeshtë), Kroacia (2006), Mali i Zi (2004), Maqedonia (2006), Romania (2005) dhe Serbia (2005) kanë **hequr dënimin me burgim** (dmth zbatohet vetëm gjyba penale);
- **Shqipëria** dhe Greqia mbeten vendet me ligjet më penalizuese në Europën juglindore;
- Kosova, Kroacia, Norvegjia, Portugalia dhe Slovakia janë disa nga vendet që po konsiderojnë depenalizimin e plotë të difamacionit (**Kosova** po harton ligj civil për difamacionin që do të zëvendësojë sanksionet penale);
- Mjaft vende të Europës Lindore, si Hungaria, Kroacia, Letonia, Republika Ceke dhe Slovakia kanë shfuqizuar shprehimisht ose shpallur anti-kushtetuese dispozitat e difamacionit që parashikojnë **mbrojtje ose sanksione të posacme për funksionarët shtetërorë**.

Së fundmi, mjaft institucione ndërkombëtare, duke përfshirë Asamblenë Parlamentare të KE-së dhe Përfaqësuesin e OSBE-së kanë kritikuar vendet perëndimore që mbajnë në legjislacion dispozita të vjetra penalizuese „të cilat megjithëse nuk zbatohen më në praktikë, shërbejnë si justifikim për ato demokraci të reja që nuk janë të gatshme të demokratizojnë legjislacionin përkatës.”⁶

2. Përmbledhje e procesit të analizës dhe konsultimit me grupet e interesit në Shqipëri

Instituti i Medias dhe Justice Initiative janë angazhuar prej më tepër se dy vjetësh për reformën e difamacionit në Shqipëri:

- Puna filloi me krijimin e një grupi teknik, i cili përcakttoi fillimisht një sërë elementësh bazë të propozimit legjislativ gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2004.
- Në vijim, propozimi në fjalë u diskutua gjerësisht në një sërë tryezash të specializuara me përfaqësues të mediave, akademisë, drejtësisë dhe të disa institucioneve shtetërore. Në vecanti, propozimi u konsultua dy

⁶ Ibid, para. 36.

herë në takime të posacme me një grup deputetësh nga të gjitha grupet kryesore parlamentare të legjislaturës së kaluar. Në përfundim të këtij procesi, u formulua një propozim i rishikuar që pasqyronte feedback-un e marrë nga të gjitha këto sfera. Ky propozim, me firmat e 23 deputetëve nga të dyja anët e sallës, u fut në procedurën parlamentare si nismë legjislative e deputetëve.

- Projektligjin e paraqitur në Kuvend e mbështetën shprehimisht, nëpërmjet letrave drejtuar Kuvendit, edhe Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Mediave dhe organizata të specializuara si Article 19, Committee for the Protection of Journalists (CPJ) etj.
- Projektligji u diskutua dhe miratua edhe nga Komisioni i Mjeteve të Informimit, por nuk arriti të miratohet, për arsye kohe, para përfundimit të legjislaturës së kaluar. Me fillimin e punës së legjislaturës aktuale, propozimi është diskutuar sërish me kryesinë e Komisionit të Mjeteve të Informimit dhe deputetë të tjerë, të cilët e kanë mbështetur atë në parim. Mjaft nga deputetët që nënshkruan nismën fillestare janë rizgjedhur në Kuvend.

Duhet theksuar se një nga shqetësimet kryesore të individëve dhe grupeve të ndryshme me të cilët jemi konsultuar në këtë proces ka qenë formulimi i një reforme që merr parasysh praktikën e deritanishme në Shqipëri dhe mënyrën se si këto dispozita ka të ngjarë të zbatohen në të ardhmen.

Analiza e praktikës gjyqësore të difamacionit pas miratimit të kodit penal aktual – bazuar kryesisht në dy studime të ngjashme të organizatës së mirënjohur ndërkombëtare Human Rights Watch (2004)⁷ dhe Institutit shqiptar për Studimet Publike dhe Ligjore – tregon se për fat të keq gjyqësia shqiptare përgjithësisht i ka injoruar edhe ato garanci që ekzistojnë në legjislacionin penal të difamacionit, duke prodhuar vendime të padrejta dhe të politizuara. Kështu, në këto procese gjyqësore penale (që zakonisht kanë edhe aspekte civile) janë evidentuar:

- cënime të parimit të prezumimit të pafajsisë dhe barrës së provës; aplikimi i gabuar i elementëve të përjashtimit të përgjegjesisë penale (vërtetësia e thënies, elementi subjektiv); cënimi i të drejtës së gazetarit për të ruajtur burimet konfidenciale; dënime me prova të pamjaftueshme apo kontradiktore; si dhe shkelje të të drejtave kushtetuese procedurale.
- Për më tepër, në proceset penale në bazë të neneve 239 dhe 240 (fyerja dhe shpifja për shkak të detyrës), të cilat ndiqen nga prokuroria në bazë të ankesës së punonjësit shtetëror, të akuzuarit, kryesisht gazetarë, janë përballur edhe me abuzimet e prokurorisë. Në një rast, për shembull, gazetari i akuzuar nga një funksionar i lartë është thirrur në prokurori mbi 10 herë për të njëjtin artikull, ku përgjegjësia penale ishte tejet e diskutueshme, për të mos thënë inekzistente. Këto lloj praktikash krijojnë një klimë frike të papranueshme jo vetëm për individin në fjalë, por gjithë sferën mediatike dhe më gjerë në shoqëri (i ashtuquajtur 'efekt frenues' ose 'chilling effect').
- Së treti, analiza e praktikës gjyqësore ka treguar një mungesë të theksuar respekti për të drejtën e fjalës dhe një tendencë për t'ia

⁷ Raporti i plotë i HRW gjendet në këtë adresë: <http://hrw.org/reports/2002/albania/albania0602.pdf>, me një përmbledhje të problemeve në ff. 22-24. Analiza e HRW është kryer në vitin 2004, por proceset gjyqësore të viteve të fundit kanë dëshmuar se të njëjtat probleme vazhdojnë.

nënshtruar atë, gati automatikisht, nderit dhe reputacionit të të dëmtuarit-akuzues, kryesisht politikanë dhe funksionarë të lartë. Kjo mund të jetë çështje mentaliteti gjyqësor, nderhyrjeje politike ose mungese kurajoje institucionale, por sidoqofte mbetet evidente – si ne ato raste, për shembull, kur gjykata ka injoruar totalisht argumentat e palës mbrojtëse të bazuara në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut (të cilës i referohet shprehimisht neni 17 i Kushtetutës). Në përgjithësi, niveli i njohjes dhe zbatimit të jurisprudencës europiane mbetet mjaft i ulët, qoftë edhe në gjykatat e apelit.

3. Përmbledhje e rekomandimeve për ndryshime në Kodin Penal dhe Kodin Civil

Duke pasur parasysh sa më lartë, dhe në vijim të diskutimeve të zhvilluara Instituti i Medias dhe Justice Initiative paraqesin rekomandimet e mëposhtme. [Kemi bashkangjitur gjithashtu si Shtojcë një draft të përgatitur nga ana jonë për deputetët në tetor 2004, i cili përmban një komentari më të plotë në lidhje me ndryshimet e propozuara.]

i. Nenet 119 (fyerja e thjeshtë) dhe 120 (shpifja e thjeshtë) KP

Për arsyet e shtjelluara më lart, ne vazhdojmë të jemi të mendimit dhe do të rekomandojmë si variant parësor që zgjidhja më optimale për Shqipërinë do të ishte shfuqizimi i plotë i këtyre neneve.

Megjithatë, nëqoftëse Kuvendi e gjykon të nevojshme ruajtjen e nenit 120 (shpifja), ne propozojmë dy ndryshime: 1. **heqjen e dënimit me burgim** si minimum; dhe 2. një riformulim si më poshtë për të bërë sa më të qartë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale:

“Përhapja e qëllimshme e thënieve të rreme me natyrë faktike që çenojnë nderin dhe reputacionin e personit, e kryer me dijeni për pavërtetësinë e tyre, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë.”

Elementi i parë (thëniet e rreme me natyrë faktike) ka për qëllim të përjashtojë përgjegjësinë penale për opinionet dhe format e tjera të shprehjes që nuk mund të jenë objektivist të rreme. Ky dallim i bazuar në jurisprudencën europiane sqarohet në mënyrë më plotë në Shtojcë tek komentari i nenit 2 për ndryshimin e Kodit Civil.⁸ Ndryshimi i dytë (me dijeni për pavërtetësinë e thënieve) thjesht saktëson elementin *mens rea* të veprës, i cili nënkuptohet nga teksti aktual i nenit.

ii. Nenet 239 dhe 240 (fyerja dhe shpifja për shkak të detyrës), neni 241 (shpifja ndaj Presidentit) dhe neni 227 (fyerja ndaj përfaqësuesve të huaj) të Kodit Penal

Nëpërmjet këtyre dispozitave Kodi Penal siguron një trajtim dhe mbrojtje të posaçme për funksionarët e shtetit, në të paktën dy aspekte: 1. duke parashikuar sanksione më të larta, në rastin e fyerjes⁹, si dhe në rastin e shpifjes kundër kryetarit të shtetit; dhe 2. më e rëndësishmja, duke sanksionuar ndjekjen e këtyre veprave nga prokuroria (ndryshe nga fyerja dhe shpifja e thjeshtë, ku nuk

⁸ Shih edhe studimin e Këshillit të Europës të cituar në shënimin 4, para. 15.

⁹ Shih ndryshimet e bëra në Kodin Penal nëpërmjet Ligjit nr. 8733, datë 24.01.2001, neni 56.

kryhet hetim paraprak dhe i dëmtuari duhet të bëjë padi private direkt në gjykatë, duke pasur dhe barrën e provës së akuzave.)

Në të njëjtën kohë, përkufizimi mjaft i gjerë i këtyre neneve mbron të gjithë "punonjësit që kryejnë një detyrë shtetërore apo një shërbim publik", duke përfshirë këtu të gjithë nomenklaturën e shtetit e më gjerë, nga nëpunësi më i ulët deri te funksionarët më të lartë të legjislativit, gjyqësorit, ekzekutivit dhe pushtetit lokal (me gjithë organet e panumërta në varësi të tyre).

Fryma dhe përmbajtja e këtyre dispozitave vijnë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me jurisprudencën e Nenit 10 të Konventës Europiane, sipas të cilës konturet e së drejtës së shprehjes janë më të gjera kundrejt politikanëve, funksionarëve shtetërorë dhe personave të tjerë publikë se sa ndaj qytetarëve të thjeshtë (privatë). Kjo është një nga parimet themelore në interpretimin që Gjykata e Strasburgut i ka bërë Nenit 10.¹⁰ Një seminar zyrtar i zhvilluar nga KE-ja në tetor 2002 e përmbodhi kështu jurisprudencën europiane në këtë fushë [në origjinal anglisht]:

*... there should be no special protection, in both substantive and procedural laws or in practice, for public officials (**including Heads of State**), in accordance with the jurisprudence of the European Court of Human Rights.¹¹*

Sic theksohet, ky parim zbatohet njëllor edhe për kryetarin e shtetit dhe është në këtë frymë që gjykatat kushtetuese të Hungarisë dhe Kroacisë i kanë shpallur anti-kushtetuese dispozita të ngjashme me nenet 239-240 dhe madje edhe ato ekuivalente me nenin 241 të Kodit Penal shqiptar.

Po e njëjta logjikë aplikohet në lidhje me dispozitat që garantojnë mbrojtje të posacme për **funksionarët e huaj** (shih nenin 227 KP). Në fund të fundit, përderisa qytetarët e një vendi kanë të drejtë të kritikojnë kryeministrin dhe presidentin e vet pa u bërë objekt ndjekjeje penale (të posacme), është vështirë të kuptohet se pse funksionarët e huaj duhen të kenë imunitet më të lartë ndaj fjalës së lirë.

Gjykata e Strasburgut e ka diskutuar pikërisht këtë situatë në çështjen *Colombani k. Francës*, duke shpallur një vendim që e detyroi Francën të shfuqizojë nenin e Kodit Penal që garantonte mbrojtje të posacme nga fyerja për kryetarët e shteteve të tjera. Në vendimin në fjalë, Gjykata Europiane u shpreh se qasja e ligjit francez ...

*...amounts to conferring on foreign heads of State a **special privilege that cannot be reconciled with modern practice and political conceptions**. Whatever the obvious interest which every State has in maintaining friendly relations based on trust with the leaders of other States, such a privilege exceeds what is necessary for that objective to be attained.*

Pra, as mbrojtja e marrëdhënieve me botën e jashtme, i cili është qëllimi i vërtetë in nenit 227 KP (shih titullin e Kreut VI KP), nuk përbën justifikim të mjaftueshëm për mbajtjen e këtij neni.

Duke pasur parasysh sa më lart, nuk ka mbetet vecse të rekomandojmë **shfuqizimin e plotë** të neneve 239, 240, 241 dhe 227 KP.

¹⁰ Për një përmbledhje të jurisprudencës relevante, shih, mes burimeve të shumta, edhe studimin e cituar në shënimin 4, para. 12-14.

¹¹ Ibid, para. 38.

iii. Nenet e tjera të Kodit Penal

Në përputhje me shpjegimet e dhëna në materialin e Shtojcës, rekomandojmë gjithashtu shfuqizimin e nenit 229 (fyerja e simboleve të huaja) dhe ndryshime në nenin 268 (poshtërimi i Republikës dhe simboleve të saj) dhe nenin 318 (fyerja e gjyqtarit).

iv. Ndryshimet në Kodin Civil

Ndryshimet në dispozitat relevante të Kodit Civil janë ndoshta më të domosdoshme se ndryshimet në Kodin Penal për shkak të rregullimit të përciptë dhe të pamjaftueshëm që i është bërë institutit të dëmit moral në Kodin Civil (neni 625). Mungesa e kriterëve dhe detajeve në përkufizimin e elementëve të ndryshëm të dëmit moral është amplifikuar më tej nga praktika gjyqësore.¹²

Propozimet tona për amendimin e Kodit Civil (shih materialin e Shtojcës, Pjesa II) kanë për qëllim të përcaktojnë një balancë të saktë mes lirisë së fjalës dhe mbrojtjes së reputacionit, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Europiane dhe zhvillimet e së drejtës së krahasuar. Si model i përgjithshëm është marrë legjislacioni përkatës i Bosnjë-Herzegovinës. Ky i fundit është hartuar me ndihmën e një grupi ekspertësh të njohur ndërkombëtarë dhe cilësohet si një nga ligjet më të avancuara të difamacionit civil në Europë. Grupi i ekspertëve ka përgatitur edhe një komentari të ligjit, të cilin mund t'ua vemë në dispozicion (në anglisht).¹³

Duke ju falënderuar dhe një herë për interesin dhe vëmendjen me të cilën po e ndiqni këtë çështje, mbetemi të gatshëm të bashkëpunojmë për finalizimin e propozimeve të reformës.

¹² Shih, për shembull, raportin e sipercituar të Human Rights Watch, kreu 'Defamation trials' dhe në vecanti 'Albanian Civil Defamation Laws'.

¹³ Teksti i plotë i ligjit boshnjak gjendet këtu: <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/UNTC/UNPAN017549.pdf>.

SHTOJCE

Draft 28.10.04

**Instituti Shqiptar i Medias &
Open Society Justice Initiative**

LIGJ

nr....., datë.....

”Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 (Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë), ndryshuar me ligjin nr. 8204, datë 10.4. 1997, ndryshuar me ligjin nr. 8279, datë 15.1.1998, ndryshuar me ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 (*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*), ndryshuar me ligjin nr. 8204, datë 10.4. 1997, ndryshuar me ligjin nr. 8279, datë 15.1.1998, ndryshuar me ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 119 shfuqizohet.

Neni 2

(Varianti I)

Neni 120 shfuqizohet.

(Varianti II)

Shpifja

Neni 120 ndryshon si vijon: “Përhapja e qëllimshme e thënieve të rreme me natyrë faktike që çënojnë nderin dhe reputacionin e personit, e kryer me dijeni për pavërtetësinë e tyre, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë.”

Koment: Penalizimi i shpifjes dhe fyerjes e ka humbur në një masë të madhe aktualitetin dhe ka shume të ngjare që në të ardhmen të mos çësohet me nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) si “i nevojshëm në një shoqëri demokratike” përderisa instituti civil i dëmit moral garanton një mbrojtje mëse të mjaftueshme të dinjitetit dhe reputacionit të individit. Edhe praktika gjyqësore e viteve të fundit tregon se paditë civile për cenim të reputacionit po i nxjerrin jashtë përdorimit ekuivalentet e tyre penale (nenet 119 dhe 120). Ndonese të prirur për dekriminalizim të plote të defamacionit (ky është edhe propozimi ynë i parë), ndryshimet që po propozojmë për nenin 120 të Kodit Penal përbejnë megjithatë një zgjidhje kompromisi duke mbajtur denimin penal vetëm për format me flagrante të defamacionit.

Ekziston një prirje e qartë kundër kriminalizimit të fyerjes dhe shpifjes nga ana e institucioneve të specializuara ndërkombëtare. Që prej vitit 1994, Komiteti për të Drejtat e Njeriut i OKB-së, në kuadrin e shqyrtimit të raporteve periodike, ka shprehur shqetësimin e tij për ekzistencën e ligjeve penale mbi shpifjen në mjaft vende, si psh Islanda, Iraku, Jordania, Norvegjia dhe Maroku. Po ashtu, Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, tre Raportuesit e Posaçëm për lirinë e shprehjes, OSBE-ja dhe Këshilli i Europës i kanë kritikuar vazhdimisht ligjet penale mbi shpifjen dhe fyerjen, duke kërkuar zëvendësimin e tyre me ligje civile të hartuara në përputhje me standardet ndërkombëtare. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Zyra e Përfaqësuesit të Lartë në Bosnjë-Hercegovinë, e cila i shfuqizoi krejtësisht ligjet penale për shpifjen duke krijuar një praktikë që është ndjekur edhe nga vende të tjera në Europën Lindore (si Gjeorgjia dhe Ukraina).

Neni 3

Neni 227 shfuqizohet.

Koment: Kjo dispozitë krijon një mbrojtje të posaçme për përfaqësuesit zyrtarë të shteteve të huaja për hir të mbrojtjes së marrdhënieve me shtetet e tjera. Duke pasur parasysh se mbrojtja e marrdhënieve me shtetet e tjera nuk konsiderohet nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (neni 10.2) si një shkak legjitim për kufizimin e lirisë së shprehjes dhe se personat publikë janë më të ekspozuar ndaj opinionit publik dhe gëzojnë të drejta më të kufizuara në drejtim të reputacionit sesa personat privatë, propozohet shfuqizimi i saj.

Neni 4

Neni 229 shfuqizohet.

Koment: Lidhja midis lirise se shprehjes dhe se drejtes se protestes eshte mese e evidente. Ne kete kuader veprimet ndaj simboleve të një shteti janë pjesë e asaj që njihet si ‘e drejta e shprehjes simbolike’, shpesh e ushtruar në formë proteste me përmbajtje politike. Sipas GJEDNJ-së dhe jurisprudencës së krahasuar, liria e shprehjes përfshin jo vetëm përmbajtjen e ideve dhe opinioneve të shprehura, por edhe formën në të cilën ato shprehen. Për më tepër, qëllimi i këtij neni është ‘mbrojtja e marrëdhënieve me shtetet e tjera’ (nga vetë titulli i Kreut VI të Kodit Penal), e cila nuk përfshihet në nenin 10.2 të Konventës Europiane si shkak legjitim për kufizimin e lirisë së shprehjes. Si rrjedhim, kriminalizimi i shprehjes simbolike në këtë kontekst nuk mund të konsiderohet një masë “e nevojshme në një shoqëri demokratike.”

Neni 5

Në nenin 235 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Fyerja e rëndë që i bëhet punonjësit në kryerje e sipër të një detyre shtetërore ose një shërbimi publik përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë.”

Titulli i nenit 235 ndryshohet në “Kundershtimi ose fyerja e punonjësit që kryen një detyre shtetërore ose një shërbim publik.”

Neni 6

Neni 239 shfuqizohet.

Neni 7

Neni 240 shfuqizohet.

Neni 8

Neni 241 shfuqizohet.

Koment për shfuqizimin e neneve 239, 240 dhe 241 dhe ndryshimin e nenit 235: Nenet 239, 240 dhe 241 krijojnë mbrojtje të posacme për punonjësit e administratës shtetërore, deri në nivelet më të larta politike, si dhe privilegje që nuk gëzohen nga individët e zakonshëm. Ndjekja penale e këtyre veprave nga prokuroria është vecanërisht problematike. Këto dispozita vijnë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimin e qartë në jurisprudencën ndërkombëtare, e sidomos ate te GJEDNJ-së, sipas së cilës politikanët, funksionarët e shtetit dhe personat publikë janë më të ekspozuar ndaj opinionit publik dhe gëzojnë të drejta më të kufizuara përsa i përket reputacionit se personat privatë.

Më konkretisht mund të përmendim jurisprudencën e GJEDNJ-së (Lingens etj) dhe të Gjykatës Inter-amerikane (Opinionit mbi ligjet desacato etj); si dhe shfuqizimin

legjislativ të dispozitave të ngjashme në Republikën Çeke, Sllovaki, Bullgari, Rumani etj; apo shfuqizimin nga Gjykatat Kushtetuese në Hungari dhe Kroaci.

Shfuqizimi i neneve 239-241 pati mbështetje unanime; megjithatë, disa deputetë shprehën mendimin se do të ishte mirë të ruhej një farë mbrojtjeje për nëpunësit civilë, kryesisht jopolitikë, që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me publikun dhe mund të fyhen në krye të detyrës. Për këtë arsye është propozuar shtesa në nenin 235, e cila krijon një mbrojtje të cilësuar për nëpunësit. Duhet theksuar se paragrafi i propozuar i mbron nëpunësit nga **fyerjet e rënda dhe të drejtpërdrejta**, dmth fyerjet në nivelin e dhunës verbale të pësuar në përmbushje e sipër të detyrës, të cilat çënojnë në mënyrë direkte autoritetin e nëpunësit dhe integritetin e veprimtarisë administrative. Në dallim nga neni aktual 239, i cili propozohet të shfuqizohet për arsyet e shtjelluara më lart, shtesa e propozuar **nuk** do të zbatohet në rastet e fyerjeve ‘në distancë’, të bëra në kuadrin e debatit publik apo në rrethana të tjera indirekte.

Neni 9

Poshtërimi i Republikës dhe i simboleve të saj

Neni 268 ndryshon si vijon: “Dëmtimi i qëllimshëm i flamurit ose stemës së Republikës së Shqipërisë të ekspozuara nga institucionet zyrtare përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë.”

Koment: Argumentet e mësipërme për shfuqizimin e nenit 229 të Kodit Penal (simbolet e shteteve të tjera) vlej në një masë të madhe edhe për ‘fyerjen e simboleve’ të brendshme. Dy aspekte të nenit 268 në përmbajtjen e tij aktuale janë vecanerisht problematike. Se pari, dispozita kriminalizon jo vetëm akte dhe veprime fizike (psh dëmtimi i flamurit), të cilat mund të provokojnë reagime të dhunshme ose prishje të rendit publik, por edhe “botime ose shpërndarje të shkrimeve”, të cilat kanë pak të ngjarë të kenë pasoja të tilla. Ne sugjerojmë që këto të fundit duhet të fshihen nga përmbajtja e nenit. Në rast se shkrimet dhe botimet kanë për qëllim destabilizimin e rendit kushtetues apo nxitjen e urrejtjes etnike etj, ekzistojnë dispozita të tjera në Kodin Penal që mund të zbatohen. (Shih për shembull nenin 225 (Shpërndarja e shkrimeve antikushtetuese); nenin 265 (Nxitja e urrejtjes etnike); dhe nenin 266 (Thirrja për urrejtje nacionale)). Në rast të kundërt, nuk ka arsye për kriminalizim të botimeve apo shkrimeve.

Së dyti, fraza “poshtërimi ... i Republikës dhe rendit kushtetues, ... [dhe] i dëshmorëve të kombit” është shumë evazive; ajo mund të përfshijë shumë forma shprehjeje që janë legjitime dhe nuk duhet të penalizohen. Për këto arsye, ne sugjerojmë që neni 268 të ndëshkojë vetëm dëmtimin e qëllimshëm të flamurit ose stemës së Republikës të ekspozuara nga institucionet.

Neni 10

Fyerja e gjyqtarit

Neni 318 ndryshon si vijon: “Fyerja e gjyqtarit, antarëve të trupit gjykues ose çdo arbitri të caktuar për një çështje, në lidhje me veprimtarinë e tyre, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.”

Koment: *Pavaresisht se gjyqtarët janë funksionarë të shtetit dhe veprimtaria e tyre i nënshtrohet opinionit publik njëlloj si pushtetet e tjera, ata kanë nevojë për një mbrojtje të posaçme për hir të veçorive dhe mbrojtjes së autoritetit të sistemit të drejtësisë. Si rrjedhim, ndryshimet që propozohen t’i behen nenit 318 nuk synojnë ta eliminojnë këto mbrojtje të posaçme. I vetmi ndryshim që propozohet në këtë kuadër është zëvendësimi i togfjalëshit “për shkak të veprimtarisë së tyre”, që është disi evaziv dhe me përmbajtje subjektive, me togfjalëshin “në lidhje me veprimtarinë e tyre.” Ky formulim e vë theksin te përmbajtja e fyerjes, që duhet të ketë lidhje me funksionin publik të gjyqtarit, dhe jo tek shkaqet që mund ta kenë shtyrë autorin e fyerjes të kryejë aktin në fjalë.*

Një ndryshim më i rëndësishëm që sugjerohet është fshirja e fjalëve “prokurorit” dhe “avokatit.” Gjyqtarët dhe arbitrat janë funksionarë që administrojnë dhenien e drejtësisë. Kjo nuk mund të thuhet për prokuroret dhe avokatët, të cilët janë pale të barabarta në procesin gjyqësor. Për më tepër, neni 10.2 i Konventës Europiane, i cili përkufizon shkaqet e mundshme për kufizimin e lirisë së shprehjes, flet për “autoritetin dhe paanshmerinë e gjyqësorit”, jo të paleve procedurale. Për pasojë, autoriteti i prokurorit dhe avokatit mund të mbrohet me mjete të tjera ligjore apo administrative, por sanksionet penale në emer të mbrojtjes së autoritetit të gjyqësorit janë të pajustificuara.

Neni 11 **Dispozita tranzitore**

Çështjet penale në proces të ngritura në bazë të neneve të shfuqizuara nga ky ligj ndërpriten me hyrjen në fuqi të tij. Të dëmtuarit akuzues në çështjet e ngritura në bazë të neneve 119, [120], 239, 240 dhe 241 të shfuqizuara kanë të drejtë të ngrajnë padi civile, në përputhje me legjislacionin civil, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Ekzekutimi i vendimeve të marra në bazë të neneve të shfuqizuara nga ky ligj ndërpritet në përputhje me nenin 3 të Kodit Penal.

Për çështjet penale në proces të ngritura në bazë të neneve të ndryshuara nga ky ligj zbatohet neni 3, paragrafi 3 i Kodit Penal.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

LIGJ

Nr. ..., datë ...

**Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 7850, date 29.7.1994,
“Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë“, ndryshuar me ligjin nr. 8536, date
18.10.1999 dhe me ligjin nr. 8781, date 3.5.2001**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh

K U V E N D I I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 8536, datë 18.10.1999 dhe me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 115, pas shkronjës dh), shtohet një shkronjë e re:
“e) një viti paditë për shpërblimin e dëmit jopasuror ndaj reputacionit”.

***Koment:** Sipas nenit 113, shkronja a) të Kodit Civil, paditë për “rivendosjen ose mbrojtjen e një të drejte vetjake jopasurore” si rregull nuk parashkruhen, përveçse kur ligji parashikon ndryshe. Meqënëse e drejta e reputacionit është qartazi një e drejtë vetjake jopasurore, mund të thuhet se padia për shpërblim të dëmit moral është një padi për “rivendosjen dhe mbrojtjen” e kësaj të drejte dhe si rrjedhim është e paparashkrueshme, në bazë të nenit 113 (a). Një interpretim tjetër është që për paditë për shkaktim dëmi moral zbatohet jo neni 113(a), por neni 115, gërma dh), i cili cakton një afat tre-vjeçar për të gjitha “paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor.”*

Pavarësisht se cili prej këtyre dy interpretimeve është më i saktë, që të dy janë problematikë nga pikëpamja e lirisë së shprehjes. Sa më tepër që kalon koha, aq më e vështirë bëhet për palët të provojnë të gjitha detajet faktike që janë shpesh vendimtare në rastet e shpifjes (shënimet dhe dokumentat humbasin, dëshmitarët harrojnë ose bëhen të pagjendshëm e kështu me rradhë). Nga ana tjetër, të dyja palët, si dhe publiku i gjerë, kanë interes që e vërteta të sqarohet sa më shpejt dhe reputacioni i personave në fjalë (reputacioni personal i paditësit dhe reputacioni profesional i

autorit, gazetarit etj të paditur) të vihet në vend pa vonesë. Për më tepër, një afat i gjatë parashkrimi do të ishte i dëmshëm edhe për vetë paditësin, padia e vonuar e të cilit do të rikujtonte publikun për së dyti për thëniet negative që mund të kenë kaluar në harresë. Për këto arsye, grupi i punës propozon shtimin e një shkronje të re në nenin 115, e cila cakton një afat parashkrimi një-vjeçar, si dhe heq çdo dyshim në lidhje me interpretimin e saktë të Kodit në lidhje me këto lloj padish.

Neni 2

Neni 625 ndryshohet si vijon:

“Personi që pëson një dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet kur:

- a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit;
- b) është cënuar në reputacionin e tij nëpërmjet përhapjes së thënieve të rreme me natyrë faktike;

Pika c) – Varianti I

- c) fyhet kujtimi i një të vdekuri nëpërmjet përhapjes së thënieve të rreme me natyrë faktike. Në këtë rast bashkëshorti i personit të vdekur ose të afërmit e tij deri në shkallën e dytë mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror në rast se është cënuar reputacioni i vetë bashkëshortit ose të afërmëve.”

Pika c) – Varianti II

- c) fyhet kujtimi i një të vdekuri nëpërmjet përhapjes së thënieve të rreme me natyrë faktike. Në këtë rast bashkëshorti i personit të vdekur ose të afërmit e tij deri në shkallën e dytë mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit, përveç kur fyerja është kryer kur personi i vdekur ka qenë gjallë dhe i është njohur e drejta e dëmshpërblimit për fyerjen e pësuar.”

Koment: Neni 2 përmban një sërë ndryshimesh të rëndësishme. Së pari, dëmi moral lidhet me konceptin e **reputacionit** të personit, që përgjithësisht ka të bëjë me vlerësimin që kanë të tretët dhe shoqëria në përgjithësi për atë person. Ky koncept zëvendëson formulimin aktual të nenit 625, cënim në “nderin e personalitetit”, i cili është një shprehje evazive pa përkufizim të qartë në ligj apo në traditën juridike shqiptare dhe atë perëndimore. Nderi dhe personaliteti janë dy koncepte të ndryshme, që nuk ka pse të përzihen. Për më tepër, nocioni i “fyerjes së nderit” është lidhur tradicionalisht me fyerjen e ndjenjave të brendshme të personit dhe të vlerësimit që ky ka për veten. Si i tillë, ky koncept ka doza të larta subjektivizmi dhe konsiderohet i tejkualuar nga jurisprudenca perëndimore, në favor të nocionit më objektiv të reputacionit.

Së dyti, neni 2 krijon përgjegjësi civile për dëmtim të reputacionit vetëm në rast të **“përhapjes së thënieve të rreme me natyrë faktike.”** Ky formulim ka dy elementë të rëndësishëm që përjashtojnë përgjegjësinë civile në varësi të natyrës së thënieve. Pikësëpari, askush nuk mban përgjegjësi për shprehjen e së vërtetës,

pavarësisht se mund të ketë cënuar reputacionin e tretëve (parimi i vjetër exceptio veritatis, që bazohet në premisën se dikush që cënohet nga e vërteta e meriton atë reputacion që ka). Për më tepër, i padituri mban përgjegjësi vetëm për përhapjen e thënieve me natyrë faktike. Gjithçka tjetër që nuk është faktike—në rradhë të parë opinionet, por edhe shprehjet simbolike apo humoristike, hiperbolat, karikaturat dhe forma të tjera të shprehjes që janë të ngjashme me opinionet dhe si rregull nuk perceptohen si deklarata fakti—nuk mund të provohen objektivisht si të vërteta ose të rreme dhe si rrjedhim nuk sjellin përgjegjësi civile. Natyra faktike ose jo e thënieve përcaktohet rast pas rasti nga gjykata, por thelbi i çështjes është nëse lexuesi objektiv e percepton apo jo thënien si një pretendim faktik.

Së treti, të njëjtat parime zbatohen edhe në lidhje me kujtimin apo reputacionin e personave të vdekur. Këtu grupi i punës propozon dy variante të ndryshme, në mënyrë që të diskutohen duke marrë parasysh edhe specifikat social-kulturore të shoqërisë shqiptare. Varianti i dytë është praktikisht identik me versionin aktual, i cili është më subjektiv dhe krijon premisa për kufizime më të gjera të lirisë së shprehjes. Varianti i parë, që është varianti i preferuar nga grupi i punës, e kufizon përgjegjësinë civile vetëm për ato raste kur thëniet e rreme cënojnë në mënyrë direkte apo indirekte edhe reputacionin e vetë familjarëve (dhe jo vetëm ndjenjat e tyre për të afërmin e vdekur).

Neni 3

Pas nenit 625 shtohet një nen i ri 625/a me titull “Përgjegjësia për cënimin e reputacionit”:

“Gjykata vendos për përgjegjësinë për cënim të reputacionit sipas nenit 625, shkronja b) dhe c), duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe në vecanti:

- a) mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve;
- b) mirëbesimin dhe respektimin e normave të etikës profesionale nga ana e autorit të thënieve;
- c) faktin nëse thëniet përmbajnë një përshkrim të saktë të thënieve të të tretëve;
- d) faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar apo me çështje me interes publik ose politik.

Personi nuk mban përgjegjësi për thëniet që përbëjnë opinione ose që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme.

Në rast se thëniet e rreme kanë lidhje me çështje me interes publik apo politik, ose me persona në funksione shtetërore apo kandidatë për zgjedhje, personi mban përgjegjësi vetëm në qoftë se i ka përhapur thëniet duke qënë në dijeni të pavërtetësisë së tyre ose duke pasur dyshime serioze për vërtetësinë e tyre.”

Koment: Neni 3 propozon shtimin e një neni të ri në Kodin Civil për të saktësuar disa parime dhe rregulla të rëndësishme që janë specifike për institutin

e dëmit moral dhe të nevojshme për të caktuar një raport të drejtë mes lirisë themelore të shprehjes dhe të drejtës së reputacionit.

Paragrafi i parë i nenit të propozuar përcakton një sërë rrethanash që duhen marrë parasysh nga gjykata në përcaktimin e fajësisë apo pafajësisë së të paditurit. Këto rrethana nuk janë vendimtare në vetvete, por duhet të shqyrtohen me kujdes të veçantë nga gjykata, së bashku me të gjitha faktet e tjera të çështjes, në vlerësimin e paligjshmërisë së aktit dhe fajit (dashjes ose pakujdesisë) së të paditurit.

Paragrafi i dytë sanksionon në mënyrë eksplicite se opinionet dhe pasaktësitë e vogla faktike nuk krijojnë përgjegjësi civile. **Liria e opinionit** është një komponent i lirisë së shprehjes me rëndësi të veçantë dhe mbrojtje maksimale. Gjykata e Strasburgut ka theksuar mëse një herë se një opinion, për nga vetë natyra e tij subjektive, nuk mund t'i nënshtrohet provës së vërtetësisë (dmth nuk ekziston “opinion i rremë”) dhe si rrjedhim askush nuk mund të ndëshkohet për përmbajtjen e opinionëve që shpreh, pavarësisht nga dëmi që këto mund t'i shkaktojnë reputacionit të të tjerëve. Natyrisht që në praktikë opinionet janë shpesh të ndërthurura me thënie faktike. Sipas jurisprudencës europiane, në rast se opinionet bazohen apo nënkuptojnë apo presupozojnë elementë faktikë që nuk i përgjigjen të vërtetës, personi mban përgjegjësi në lidhje me këto të fundit. Siç u theksua dhe më lart, përcaktimi i natyrës së thënieve bëhet rasti pas rasti nga gjykata.

Paragrafi i tretë përmban një nga dispozitat më të rëndësishme të propozimit, që ka të bëjë me atë që njihet si **liria e debatit politik**. Sipas Gjykatës Europiane, kjo liri “qëndron në thelb të konceptit të një shoqërie demokratike që përshkon të gjithë Konventën” (Oberschlick k. Austrisë). Në përkufizimin e Gjykatës së Strasburgut, një pjesë e rëndësishme e debatit politik janë debatet që kanë të bëjnë me aspektet e ndryshme të punës dhe veprimtarisë së funksionarëve të shtetit, si dhe të kandidatëve zgjedhorë që kërkojnë mandatin e përfaqsimin popullor. Për këta persona publikë “kufijtë e kritikës së pranueshme janë më të gjerë ... se sa në rastin e personave privatë” dhe, për pasojë, ata “duhet të tregojnë një shkallë më të lartë tolerance” (Lingens k. Austrisë). Megjithatë, debat politik, në kuptimin e gjerë të fjalës, konsiderohen edhe ato botime, thënie etj që prekin sferën e veprimtarive të personave privatë por që për nga natyra e çështjeve që ngrenë janë me rëndësi për publikun dhe interesin publik (Sunday Times, Bergens Tidende, Hertel).

Në mënyrë që të mbrohet liria e debatit politik, në këto dy komponentë të saj, ka lindur nevoja që të modifikohen rregullat përkatëse të përgjegjësisë civile. Kështu, në kontekstin e debatit politik juridiksionet më të përparuara perëndimore dhe të vendeve në tranzicion e kanë zëvendësuar konceptin e përgjegjësisë strikte (dmth përgjegjësisë automatike për çdo gabim faktik) me një përgjegjësi të cilësuar, ku i padituri nuk mban përgjegjësi për gabime të bëra nga pakujdesia e zakonshme, por vetëm për pasaktësi faktike të bëra me **dashje ose pakujdesi të rëndë** në verifikimin e fakteve. Në formulimin e propozuar dashje konsiderohet dijenia e plotë për pavërtetësinë e thënieve të përhapura, ndërsa përhapja e thënieve të rreme megjithëse autori ka pasur “dyshime serioze për vërtetësinë” e tyre përbën një lloj pakujdesie të rëndë. Të dyja këto forma të fajit në kontekstin e

debatit politik, dijenia e plotë dhe dyshimet serioze për vërtetësinë e fakteve, janë forma subjektive që kanë të bëjnë me qëndrimin mendor të të paditurit në momentin e përhapjes së thënieve.

Neni 4

Pas nenit 647 shtohet një nen i ri 647/a me këtë përmbajtje:

“Gjykata cakton masën e shpërblimit për dëmin jopasuror ndaj reputacionit duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe në vecanti:

- a) bërjen e sqarimeve ose përgënjeshtimeve në lidhje me thëniet e rreme, si dhe cdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të reputacionit të personit të dëmtuar;
- b) marrjen e masave për zvogëlimin e dëmit nga personi i dëmtuar, në vecanti duke kërkuar përgënjeshtimin e thënieve të rreme nga autori i tyre;
- c) faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime materiale nga përhapja e tyre, si dhe masën e përfitimit;
- d) nëse dëmshpërblimi mund të shkaktojë vështirësi të mëdha financiare ose falimentimin e shkaktuesit të dëmit.”

Koment: Neni i ri i propozuar në lidhje me masën e dëmshpërblimit bazohet mbi **parimin e proporcionalitetit** të dëmshpërblimit me shkallën e fajësisë së të paditurit dhe dëmit moral të shkaktuar. Edhe në këtë rast, natyra e institutit të dëmit moral dhe interesave të palëve bën të nevojshme vendosjen e disa rregullave specifike. Kështu, projekt-dispozita e detyron gjykatën të marrë parasysh masat që mund të kenë marrë secila nga palët, vullnetarisht ose sipas ligjit, për të minimizuar dëmin ndaj reputacionit të personit përpara se konflikti mes tyre të zgjidhet gjyqësisht. Në rastin e dëmit moral, mënyra më e plotë dhe e preferuar për çbërjen e dëmit dhe rivendosjen e reputacionit të njollosur është nëpërmjet pranimit të gabimit nga ana e shkaktuesit të dëmit. [Projektligji për shtypin që po diskutohet në Kuvend i rregullon në mënyrë të detajuar të drejtat e medias dhe individëve në këtë fushë.] Publikimi i **përgënjeshtimit** nuk ja heq të dëmtuarit të drejtën të kërkojë edhe dëmshpërblim monetar, por përbën një rrethanë që duhet të merret parasysh nga gjykata si faktor lehtësues për të paditurin. Kjo është e vërtetë edhe në rast se botimi i ndreqjeve dhe përgënjeshtimeve është i detyrueshëm me ligj sepse, pavarësisht nga motivet subjektive të palëve, përgënjeshtimi objektivisht ka reduktuar dëmin ndaj reputacionit të paditësit. Nga ana tjetër, në rast se personi i dëmtuar nuk kërkon përgënjeshtimin apo ndreqjen e fakteve që ai i konsideron të pavërteta, para se t’i drejtohet gjykatës, edhe kjo rrethanë duhet të merret parasysh nga gjykata, si rregull në favor të të paditurit.

Gërma d) e nenit të propozuar ka të bëjë kryesisht me organet e medias, mbijetesa financiare e të cilave, dhe sidomos mediave të vogla, mund të rrezikohet nga dëmshpërblimet e larta. Meqënëse është përgjithësisht në interesin e debatit demokratik që mediat të mos shpërbëhen për shkak të gabimeve faktike që mund të bëjnë, gjykatat duhet të marrin në konsideratë edhe aftësinë paguese të medias në fjalë në caktimin e masës së shpërblimit.

Neni 5

Në çështjet civile për cënim të reputacionit që janë ende në proces në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zbatohet legjislacioni civil në fuqi në kohën e ngritjes së padive përkatëse.

***Koment:** Ndryshimet e bëra me këtë ligj do të zbatohen vetëm për paditë civile të ngritura pas hyrjes së tij në fuqi. Megjithatë, duhet theksuar se këto ndryshime pasqyrojnë në një masë të madhe jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Konventa Europiane, e cila është inkorporuar në sistemin e brendshëm juridik shqiptar (shih nenet 17 dhe 122 të Kushtetutës), është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 2 tetor 1996. Si rrjedhim, këto ndryshime kanë vlerë udhëzuese për gjykatat në zgjidhjen e konflikteve për dëm moral në periudhën tranzitore.*

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.